



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 261/5 prot.

Tiranë, më 24.7.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Miranda Andoni
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.7.2020, është njoftuar vendimi nr. 257, datë 12.6.2020, për subjektin e rivlerësimit znj. Miranda Andoni, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Miranda Andoni ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit

të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si IKLD), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin znj. Miranda Andoni¹*”, ka referuar se:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të dy raporteve² mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, pasi Komisioni ka kërkuar përditësimin e raportit të parë, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 **Inspektorati i KLD-së**, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 *Për vlerësimin e pasurisë.* Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

3.2 *Për kontrollin e figurës.* Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dy raporte mbi verifikimin e figurës, të cilat konfirmojnë përshtatshmërinë e subjektit për vijimin e detyrës, informacioneve nga agjencitë ligjzbatuese dhe, pasi ka kryer hetimin administrativ për këtë qëllim, ka vlerësuar se nuk janë gjetur elemente që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

3.3 *Për vlerësimin e aftësive profesionale.* Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin

¹ Raporti me nr. *** prot., datë ***.6.2018, ILDKPKI.

² Raporti me nr. *** prot., datë ***.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.2.2020, përditësuar me raportin me nr. ***, datë ***.12.2019, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.2.2020.

e përgatitur nga KLD-ja, rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, hetimin dhe vlerësimin të (15) denoncimeve nga publiku, nga të cilat për një rast, në çështjen civile të gjykuar nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. ***, datë ***.5.2015, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar senancën gjyqësore pa dijeninë e personit të tretë (denoncuesit), në përfundim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Andoni, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm vlerësimi për të tria kriteret, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastër.

*- Transferimin e çështjes civile nr. *** Akti, me palë ndërgjyqëse: paditës ***,***, e paditur Zyra Përmbartimore “***” sh.p.k., person i tretë *** (***) ***, të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. ***, datë ***.5.2015, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.*

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b, të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në vlerësimin e akteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 257, datë 12.6.2020, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Andoni, nuk gjejnë mbështetje në prova dhe në ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues. Vetëm në

këtë mënyrë, faktet dhe rrethanat e dala nga aktet e administruara, bazuar edhe në një vlerësim tërësor të të tria kriterëve, objektivisht do të justifikonin arritjen e nivelit të besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

10. Komisioneri Publik, duke çmuar se ky vendim objekt ankimi, shfaq edhe mangësi në hetimin administrativ, konstaton se indiciet e dala nga aktet e administruara janë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që brenda juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, ky i fundit në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor për të tria kriteret, pasi rezulton se hetimi i Komisionit nuk ka qenë shterues në drejtim të indicieve të rezultuara nga institucionet, si: OSHEE, DPPP dhe UKT, të cilat eventualisht do të ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerësimin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

11.1 Gjithashtu, në varësi edhe të rrethanave që mund të dalin për sa më sipër, lidhur me çështjet e tjera të hetuara nga Komisioni dhe për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës, në konsideratë të synimit të përcaktuar nga neni 179/b, pika 1, të Kushtetutës, dhe në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se, si çështje e rishikimit gjyqësor të Kolegjit, të përfshihen edhe përfundimet e arritura nga Komisioni për të tria kriteret, pasi:

- (i) Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, pasi përveç sa ka konstatuar Komisioni gjatë hetimit administrativ për diferencat negative për vitet 2008 (rezultat negativ i konstatuar për mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të kryerjes së pagesave në datën 12.6.2008) dhe të vitit 2010, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet edhe për vitet 2011 dhe 2016;
- (ii) Për sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në kërkesat e nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, nga raporti i hartuar nga KLD-ja dhe hetimi administrativ i Komisionit, kanë rezultuar të njëjta mangësi në drejtim të arsyetimit ligjor, aftësive organizative të subjektit, të administrimit të dosjeve, respektimit të afateve ligjore në arsyetimin e vendimeve, njoftimit të palëve, zvarritje të gjykimit tej afateve ligjore etj.

Duke i marrë së bashku këto gjetje, përfshirë dhe çështjen civile nr. *** 2015 Akti, të transferuar nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga sa ka arritur Komisioni.

12. Komisioneri Publik, në vijimësi të qëndrimeve të mbajtura nga ky institucion në ushtrimin e ankimeve, nëpërmjet të cilave kërkohet hetimi i mëtejshëm i kriterëve të rivlerësimit, vlerëson se edhe kontrolli i figurës së subjektit, bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreun V, të ligjit nr. 84/2016, duhet t’i nënshtrohet hetimit dhe vlerësimit

nga ana e Kolegjit, për të arritur në një vendimmarrje përfundimtare në konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit.

13. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

II. A Analiza e shkaqeve të ankimit

Për vlerësimin e pasurisë

14. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Komisioneri Publik, në vlerësim të kriterit të pasurisë, është bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, të cilat, në gjendjen që janë, paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi konstatojmë se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues. Kështu, nga verifikimi i akteve në dosjen e Komisionit, rezulton se:

15.1 Nga korrespondenca me OSHEE-në, kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2019, ka konfirmuar disa kontrata furnizimi të energjisë elektrike në emër të personave të lidhur të subjektit të rivlerësimit, për të cilat nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar apo vlerësuar më tej këto të dhëna.

15.2 Ndërkohë, me UKT-në, nuk rezulton të jetë hetuar apo mbajtur korrespondencë për të verifikuar ekzistencën e kontratave të lidhura nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

15.3 Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2019, ka konfirmuar se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, del si palë nënshkruese në disa kontrata kredie, ku sipas informacionit të dokumentuar, për kontratën e datës ***.6.2012, me vlerë 2.400.000 lekë, burimi i fondeve përshkruhet si: "të ardhura familjare". Ky informacion nuk përputhet me informacione të konfirmuar nga DPPPP-ja, me shkresën nr. ***, datë ***.5.2017, dërguar ILDKPKI-së, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

15.4 Rezulton se këto indicie nuk janë hetuar nga Komisioni, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjes, në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë apo të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kritereve, sipas përcaktimit të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

15.5 Vlerësimi i këtyre rrethanave merr rëndësi në rastin konkret, pasi eventualisht ato do të ndikonin në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

16. Për sa i përket çështjeve të hetuara dhe për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës, bazuar mbi të njëjtat prova të administruara, Komisioneri Publik ndan gjykim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me pasuritë “apartament banimi me sip. 123.5 m²” dhe “garazh me sip. 26.9 m²”, të ndodhur në Tiranë.

16.1 Rezulton se në *Deklaratën “Vetting”* (në vijim referuar si D-Vett.), subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sip. 123.5 m², në adresën: rruga “****”, ****.***, Tiranë, blerë me kontratë shitje nr. ***, datë ***.6.2008. *Vlera* 105.600 euro, *Pjesa takuese* 50%. Garazh, vendparkim automjeti (në bashkëpronësi me bashkëshortin ****.***), me sip. 26.9 m², me adresë: rruga “****”, ****.***, Tiranë, blerë me kontratë shitjeje nr. ***, datë ***.6.2008, në vlerën 13.000 euro. *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i krijimit*: të ardhura nga kursimet familjare ndër vite, nga pagat, gjendje në llogari bankare në *** Bank. *Burimi i krijimit*: kredi dhe kursimet familjare ndër vite, nga pagat familjare.

16.2 Në *deklaratën e interesave periodike 2008* (në vijim referuar si DV-2008), subjekti ka deklaruar: Apartament banimi, ***, Tiranë, me sip. 123.5 m², kontratë shitjeje nr. ***, datë ***.6.2008. *Vlera* 105.600 euro, *Pjesa takuese* 50%. Garazh, ***, Tiranë (në bashkëpronësi me bashkëshortin ****.***), me sip. 26.9 m², me adresë: rruga “****”, ****.***, Tiranë, blerë me kontratë shitje nr. ***, datë ***.6.2008, vlera 13.000 euro. *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i krijimit*: nuk deklarohet.

16.3 Në vlerësim të burimit të ligjshëm të deklaruar për krijimin e këtyre dy pasurive, kredi për blerje banese dhe kursimet familjare ndër vite nga pagat familjare, Komisioni ka vlerësuar se:

16.3.1 Në lidhje me burimin kredi bankare, subjekti ka deklaruar rregullisht dhe sipas ligjit shumat përkatëse të shlyerjes së kredisë, si dhe detyrimet financiare në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2008 – 2016.

16.3.2 Në lidhje me burimin: kursimet familjare ndër vite me të ardhura nga pagat, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore dhe dokumentet zyrtare që vërtetojnë të ardhurat nga pagat, ka rezultuar se në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003 – 2007, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar në fund të çdo viti likuiditete/kursime të krijuara me të ardhurat nga pagat, të cilat që prej vitit 2004 e në vijim kanë qenë të depozituara në llogaritë bankare, dhe këto kursime janë shtuar nga akumulimi i pagave dhe i interesave bankare.

16.3.3 Nga lëvizjet e llogarive është konstatuar se pjesë përbërëse e likuiditeteve në depozitat bankare deri në datën 12.6.2008 është dhe një transferim në llogari, i shumës 3.780 euro, shumë kjo e deklaruar nga subjekti në DV-2008 si ndihmë nga e ëma e saj në llogarinë e bashkëshortit. Ky deklaram është bërë vetëm në DV-2008 dhe jo në D-Vett. Kjo shumë së bashku me shumën e akumuluar deri në këtë datë, në depozitat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj, është transferuar për pagesën/këstin e parë për pasuritë “apartament banimi dhe garazh”.

16.3.4 E pyetur nga Komisioni në lidhje me mosdeklarimin e kësaj shume në D-Vett., si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj, referuar parashtrimeve të datës 10.3.2020 dhe në seancën

dëgjimore, subjekti ka deklaruar: “... mospasqyrimi i kësaj ‘huaje’ në deklaratën ‘Vetting’, ka qenë një pakujdesi gjatë plotësimit të kësaj deklarate për shkak të ngarkesës gjatë mbledhjes së dokumentacionit, duke mos u thelluar në analizën e transaksionit financiar, pasi shuma e marrë hua nga nëna ***,***, në masën 3.780 euro, nuk ka qenë si veprim financiar më vete... Mospasqyrimi në Deklaratën ‘Vetting’ nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij veprimi, i cili është deklaruar menjëherë në deklaratën vjetore për vitin 2008 dhe, për më tepër, kjo shumë e marrë nga nëna, ***,***, zë një masë relativisht shumë të vogël në vlerën totale të transaksionit”.

16.4 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka pasur asnjë arsye dhe motiv për të fshehur në Deklaratën “Vetting” shumën e dhënë nga nëna e saj në vitin 2008, përkundrazi, mungesa e deklarimeve në lidhje me këtë shumë e ka vënë në kushtet e pasaktësisë në deklaram.

16.5 Për sa i takon ligjshmërisë së burimeve financiare për krijimin e shumës prej 3.780 euro nga znj. ***,***, person tjetër i lidhur, Komisioni i ka kërkuar subjektit të vërtetojë me dokumente shkresore burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. ***,***, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32 të këtij ligji.

16.5.1 Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se: “si burim i shumës 3.780 euro së dhënë prej nënës së saj kanë shërbyer të ardhurat nga pensioni i znj. ***,***, dhe të ardhurat e dhuruara në formë ndihmë financiare nga të dy djemtë e saj (vëllezërit e subjektit), emigrantë në shtetin grek, të quajtur ***,***, dhe ***,***, për të cilët subjekti deklaroi se nëna e tyre ka pasur ndihma financiare deri në vitin 1997.

16.5.2 Në vlerësim të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e ligjshme të vëllezërve nga emigracioni³ dhe shuma e dhënë nga personi tjetër i lidhur nuk mbulohet me burime të ligjshme.

16.5.3 Nga analiza financiare deri në datën 12.6.2008, fillimisht Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet e jetesës dhe pagesat për një diferencë negative prej - 201.859 lekë. Por, pasi ka analizuar dhe marrë në shqyrtim shpjegimet dhe provat e subjektit, ka vlerësuar të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit mbi të ardhurat nga interesat bankare dhe të ardhurat nga qiratë për periudhën janar 2008 - qershor 2008, në shumën prej 102.000 lekësh, tatimi për të cilat është paguar gjatë procesit të vlerësimit në datën ***,3.2020. Pas rishikimit të këtyre treguesve, Komisionit i ka rezultuar se balanca negative për periudhën deri në datën 12.6.2008, është në shumën prej 89.908 lekë.

17. Komisioneri Publik, në lidhje me burimin e deklaruar si kursime familjare ndër vite, konstaton se rezultatet e analizës financiare të Komisionit mbi burimet e ligjshme për shlyerjen e pagesës së pasurive, nuk mbështeten në gjendjen faktike të akteve në dosje dhe me arsyetimin ligjor të bërë prej tij.

³ Subjekti ka paraqitur: kopje të dy pasaportave ndërkombëtare të skaduara të vëllait të vogël, z. ***,***, me të cilat vërtetohen lëvizjet e këtij shtetasi në Greqi për periudhat 2005 – 2015 dhe 2009 – 2019; dokument në gjuhën greke (kartë greke) të shtetasis ***,***, në shtetin grek me afat vlefshmërie 2006 – 2015; vërtetim të lëshimit të numrit të regjistrimit të tatimor grek të vitit 2002 për shtetasin ***,***, datë ***,8.2002; vërtetim regjistrimi të të siguarit ***,***, në shtetin grek, datë ***,4.2004.

17.1 Për sa u analizua më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se personi tjetër i lidhur, nëna e saj, mbulon me burime të ligjshme shumën e dhënë në formë ndihme/huaje në vlerën 3.780 euro. Duke qenë se kjo shumë është depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit, atëherë bën pjesë në zërin “shtesa/pakësime likuiditete” dhe, si e tillë, vlerësojmë se në këtë zë, e gjithë shuma prej 3.780 euro ose kundërvlera e saj në lekë, nuk duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm i pagesës së blerjes së pasurive “apartament dhe garazh”.

17.2 Gjithashtu, referuar dhe qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 8/2019, vlerësojmë se në analizën financiare të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive deri në periudhën e kryerjes së pagesës në qershor 2008, nuk duhet konsideruar shuma e pretenduar nga subjekti mbi të ardhurat nga qiradhënia, pasi rezulton se për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2008 nga ky burim, detyrimet tatimore janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit⁴.

17.3 Komisioneri Publik vlerëson se të dyja shumat e sipërcituara (3.780 euro dhe 102.000 lekë) nuk duhej të ishin përfshirë si të ardhura të ligjshme në vlerësimin e burimit të krijimit të pasurive, duke rezultuar në pamjaftueshmëri në këtë masë.

17.4 Lidhur me burimin e deklaruar si kredi bankare dhe shlyerjen e saj ndër vite, përpos sa është konstatuar nga Komisioni mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për mbulimin e shpenzimeve në vitin 2010,⁵ nga vlerësimi i të dhënave na rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe shlyerjet e parakohshme të kredisë edhe për vitin 2011, në shumën – 408.153 lekë dhe vitin 2016, në shumën – 139.631 lekë⁶.

18. Duke përfunduar për kriterin e pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e deklaruar për vitet 2008 - 2016. Kjo pamjaftueshmëri, në varësi edhe

⁴ Subjekti në vitin 2008 nuk ka kryer pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja në periudhën deri janar 2009, sipas parashikimeve ligjore, por këtë pagesë e ka kryer gjatë procesit të rivlerësimit. Kolegji, në vendimin nr. 8, datë 16.4.2019, prg. 63, ka mbajtur qëndrimin se “...tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhura të viteve 2006-2012, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit”.

⁵ Referohuni analizës financiare në tabelën përmbledhëse në f. 24, të vendimit të Komisionit.

⁶ Në zërin të ardhura janë përfshirë të ardhurat që plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, konkretisht: të ardhurat e subjektit, bashkëshortit dhe vajzës sipas konfirmimeve zyrtare të institucioneve, bazuar edhe në kreditimet në llogaritë bankare; të ardhurat nga pensioni i vjehrrës për vitet deri në 2006, vit në të cilin vjehrra deklarohet nga subjekti si pjesë e përbërjes familjare; të ardhurat nga qiraja, vetëm për vitet në të cilat provohet pagesa e detyrimeve tatimore në periudhën e realizimit të tyre; të ardhurat nga interesat bankare, konvertuar në monedhën lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë në vitin e përfitimit të tyre. Në zërin shpenzime janë përfshirë shpenzimet e jetesës INSTAT sipas përbërjes familjare të deklaruar nga vetë subjekti; shpenzimet për shlyerje kredie sipas lëvizjeve të llogarive bankare dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, konvertuar me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë të vitit respektiv; shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, bazuar në deklaratimet periodike vjetore, si dhe pagesave të evidentuara nga lëvizjet në llogaritë bankare të konvertuara me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë; shpenzime mobilimi sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ; shpenzime udhëtimi sipas metodologjisë së përdorur nga Kolegji në jurisprudencat e deritanishme, në rastet kur subjekti ka deklaruar çmimet e biletave dhe hotelerisë në deklaratat periodike vjetore, këtyre shpenzimeve iu është shtuar vetëm pjesa e ushqimit, në masën 50% të kostos ditore, prej 50 euro. Në zërin ndryshime në likuiditete janë përfshirë: kursimet në cash sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore; kursimet në llogari rrjedhëse dhe depozita bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, konfirmimeve të institucioneve financiare bankare, të konvertuara në monedhën lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën e kryerjes së transaksionit në rastet e depozitimit të shumave në cash dhe në rastin e kapitalizimit të interesave është përdorur kursi mesatar i këmbimit të vitit të përfitimit të interesit.

të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet këtij ankimi, do të ndikonte në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, në këndvështrim të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

19. Bazuar në nenin E, pika 2, fjalia e dytë e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 40, të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësive profesionale për magjistratët gjyqtarë, përfshihen kriteret e *aftësitë për të gjykuar, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimi profesional*, referuar standardeve të parashikuara në ligj.

20. Sikurse shihet, qëllimi i vlerësimit të këtij kriteri sanksionohet drejtpërdrejt nga kjo dispozitë e aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës subjektet i nënshtrohen rivlerësimit të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Rezultatet e dala nga ky vlerësim, sipas rastit dhe rrethanave të çështjes, duhen parë lidhur dhe me vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21. Sipas nenit 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, burimet mbi të cilat vlerësohen subjektet e rivlerësimit merren nga burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, në vendimin (JR) me nr. 21/2019, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se: *[... kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm].*

22. Në vështrim të sa më sipër, nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, znj. Andoni, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjektit i janë kërkuar shpjegime. Referuar burimeve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, raport-vlerësimit të KLD-së, hetimit administrativ të Komisionit, të dhënat e dala nga denoncimet e publikut, problematikat dhe mangësitë e gjetura janë si vijon:

22.1 Lidhur me treguesin, *aftësitë profesionale - arsyetimi ligjor*, referuar të dhënave për dosjet nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4, objekt vlerësimi sipas nenit 43/2, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se vendimet e ndërmjetme arsyetohen në nivelin minimal dhe në përgjithësi atyre u mungon referenca ligjore. Ndërsa për dosjet nr. 2 dhe nr. 3, subjekti nuk disponon me vendime të ndërmjetme. Në pjesën hyrëse të vendimit, mungon data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjeneralitetet e plota të palëve apo aktet e përfaqësimit të tyre.

22.2 Lidhur me treguesin, *aftësitë organizative, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet*, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, për dosjen nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4, është konstatuar se subjekti i ka arsyetuar vendimet gjyqësore jashtë afatit ligjor. Subjekti nuk disponon me vendim/urdhër formal për caktimin e seancës dhe nuk kujdeset që aktet e njoftimit të përfshihen rregullisht në dosje. Mangësitë në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të, janë të njëjta në dosjet e

vëzhguara si: aktet e njoftimit të palëve mungojnë në dosje apo nuk përfshihet në dosje lista e shpalljeve, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes etj.

22.3 Lidhur me treguesin, *aftësitë personale dhe angazhimi profesional - aftësia për të bashkëpunuar*, në dosjet nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4, është konstatuar vonesë në depozitim të tyre në sekretarinë gjyqësore.

22.4 Lidhur me tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

22.5 Çështja civile, me palë ****.**** dhe ****.****, regjistruar më datë ****.4.2013* dhe përfunduar më datë ****.4.2014*, ka zgjatur 1 vit e 20 ditë. Periudhë nga e cila, pas marrjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatores, çështja ka zgjatur 9 muaj e 20 ditë. Pra, në tejkallim të afatit 6-mujor të gjykimit civil, referuar vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, të KLD-së.

22.6 Çështja penale me të pandehurin ****.****, regjistruar më datë ****.3.2014* dhe përfunduar më datë ****.2.2015*, ka zgjatur 11 muaj e 7 ditë. Pra, në tejkallim të afatit 6-mujor të parshikuar për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit.

22.7 Tejkallim në afatet e gjykimit janë konstatuar edhe për raste të tjera, pasi nga burimet arkivore të KLD-së, ka rezultuar, ndër të tjera, se janë regjistruar **tri ankesa të vitit 2016**, të cilat, pasi janë verifikuar për zvarritje gjykimi, në përfundim janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për subjektin e rivlerësimit.

22.8 Komisioni, për sa më sipër, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se, për tejkallimin e afateve të gjykimit, ka krijuar bindjen se zgjatja e afateve në çdo rast nuk ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe të përligjura. Për sa i takon mangësive të tjera të vërejtura, Komisioni ka vlerësuar se këto parregullsi nuk tregojnë që subjekti ka njohuri, aftësi në gjykim, qëndrime ose modele pune të dobëta, të tilla sa të kenë rrezikuar dhe cenuar të drejtat e qytetarëve apo ato të jenë bërë pengesë në mbarëvajtjen e proceseve. Në përfundim, Komisioni, bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, referuar neneve 72-77, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit arrin nivel minimal kualifikues, sipas nenit 58, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

22.9 Ndërsa për faktet e rrethanat e dala nga denoncimet e publikut, për një rast, Komisioni, pasi ka vlerësuar se seanca gjyqësore është zhvilluar pa dijeninë e rregullt të personit të tretë, denoncuesit, subjekti nuk ka përmbushur detyrimet e nenit 4 të Kodit të Procedurës Civile, e për këtë arsye, ka vendosur transferimin e çështjes pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

23. Komisioneri Publik, duke konsideruar se shkaqet e ankimit do të mundësojnë për Kolegjin të vendosë nëse rezultati i vlerësimit të aftësisë profesionale në rastin konkret është i justifikuar, parë kjo edhe në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, ndan qëndrim të ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni.

23.1 Bazuar në gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nga IKLD-ja, të konfirmuara dhe nga hetimi administrativ i Komisionit, në pamundësi të vlerësimit të dosjeve fizike objekt vlerësimi, Komisioneri Publik do të ndalet në faktin e konstatuar të tejkallimit të afateve të gjykimit, si model i vërejtur në më shumë se një herë në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi ky fakt së bashku dhe me mangësitë e tjera, në këndvështrim të

nenit E, pika 5, të aneksit të Kushtetutës, përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

23.2 Parimi i zhvillimit të procesit brenda afateve të arsyeshme është një parim kushtetues, respektimi i të cilit mundëson realisht vënien në vend të të drejtave të personave. Kjo e drejtë reflektohet edhe në postulatin e njohur: “*Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar*”. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm rrjedh nga detyrimi i përcaktuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe nga neni 28 i Kodit të Procedurës Civile.

23.3 Gjykimi brenda afateve të arsyeshme lidhet edhe me kriterin e ekonomisë gjyqësore, pasi një proces i shpejtë dhe efektiv do të shmangte shpenzime gjyqësore të panevojshme për palët. Ky problem, mosrespektimi i afateve të arsyeshme, ka qenë dhe duket se vijon të jetë një nga problemet më të mëdha të proceseve gjyqësore në vend. Për këtë qëllim, vlen të përmendim çështjet e gjykuara nga GJEDNJ-ja në rastin *** kundër RSH dhe *** kundër RSH të vitit 2007, konsideruar si vendime “pilot”, për të kuptuar rëndësinë, ndjeshmërinë dhe pasojat që sjell shkelja e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

23.4 Për të vlerësuar “karakterin e arsyeshëm të zgjatjes së procesit”, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka pranuar se ky vlerësim duhet të bëhet mbi bazën e rrethanave të veçanta të çështjes, si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit, sjellja e autoriteteve kompetente, si dhe rëndësinë e çështjes për të drejtat e palëve, konsideruar këto si elemente të nevojshme vlerësimi⁷.

23.5 Në këtë këndvështrim, Komisioni, me të drejtë, i është referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr. ***/2015 dhe nr. ***/2016), por duket se këto rrethana nuk janë bazuar në një hetim apo vlerësim të mirëfilltë mbi bazën e gjendjes së akteve në dosje. Për të gjitha problematikat e konstatuara, Komisioni i ka marrë të mirëqena pretendimet e subjektit duke i konsideruar bindëse.

23.6 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, vlerëson se është përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme me bazën ligjore përkatëse, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrekhtësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor.

III. Kërkimi i ankimit

24. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

25. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në

⁷ Për më tepër, referohuni në vendimin: “*** dhe të tjerët vs Italisë”, 1991.

procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

26. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, 30-34, 40-44, pikës 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

27. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA